



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave

Ministry of Local Government Administration

Për :	Ragip Begaj , Kryetar i Komunës së Malishevës Rrahim Morina , Kryesues i Kuvendit të Komunës së Malishevës	
Kopje	Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njësia për Administrimin e Dokumenteve në Komunë	
Përmes:	124 Ivan Todosijević , Ministër i MAPL-së Rozafa Ukimeraj , Sekretare e Përgjithshme e MAPL-së	
Nga:	Venera Çerkini , U.d Udhëheqës i Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave MAPL	Datë: 22/11/2018 Nr. 020-1337
Lënda:	Kërkesë për rishqyrtim të ligshmërisë së aktit të Kuvendit të Komunës së Malishevës	
Lloji i aktit:	Vendim i Kuvendit të Komunës	

I nderuar Kryetar,
I nderuar Kryesues,

Në pajtim me Rregulloren e QRK-së Nr. 01/2016 për Shqyrtimin administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 02/2011 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr.03/L-040 Për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

Vendim Nr. 02-484 që kërkohet nga kryetari i komunës për shkarkimin e Drejtorit të Shkollës "Hamdi Berisha" z. Izet Hoti
I miratuar më datë më datë: 16.11.2018
I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 21.11.2018

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës është në kundërshtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi.

Mos pajtueshmëritë e aktit të komunës të parashtruar për shqyrtim të ligjshmërisë janë si në vijim:

Nr.	Formulimi në aktin e komunës	Dispozita ligjore me të cilën akti i komunës është në kundërshtim.
1.	Vendim Nr. 02-484 që kërkohet nga kryetari i komunës për shkarkimin e Drejtorit të Shkollës "Hamdi Berisha" z. Izet Hoti	Vendimi Nr. 02-484 i miratuar nga kuvendi i komunës së Malishevës, nuk është në kompetencë të kuvendit të komunës së Malishevës dhe si i tillë nuk prodhon efekt juridik. Kuvendi i Komunës së Malishevës mund vetëm të rekomandoj Kryetarit të Komunës ndërmarrjen e veprimeve për këtë çështje.

Bazuar në të cekurat më lartë, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal kërkon nga Kuvendi i Komunës/Kryetari i Komunës që të ndërmarrin veprime konkrete që aktin e komunës ta harmonizojnë me dispozitat ligjore në fuqi, brenda 30 ditësh nga data e pranimit të kërkesës për rishqyrtim të aktit. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm në lidhje me këtë vlerësim.

U nastavku ćete naći neusklađenost predloženog akta opštine za razmatranje zakonitosti kao u nastavku:

Br.	Formulisano u aktu opštine	Zakonske odredbe sa kojima je akt opštine u suprotnosti
1.	Odluka br. 02-484 zahtev od gradonačelnika opštine za razrešenje direktora Osnovne škole "Hamdi Berisha" g. Izeta Hotija.	Odluka br. 02-482 usvojen od Skupštine opštine Mališeva, nije u nadležnosti Skupštine opštine Mališeva i kao takav ne proizvodi pravno dejstvo. Skupština opštine Mališevo može samo preporučiti gradonačelniku da preduzme aktivnosti u vezi sa ovim pitanjem.

Iz gore navedenog, Ministarstvo administracije lokalne samouprave od gradonačelnika i Skupštine opštine traži da preduzimaju konkretne mere kako bi akt opštine uskladile za zakonskim odredbama na snazi i u vremenskom roku od 30 dana, od dana primanja zahteva za razmatranje akta opštine. Ministarstvo administracije lokalne samouprave, ostaje na raspolaganju opštine za bilo koje objašnjenje u vezi sa ovom procenom.



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË

INSTITUTI I ADMINISTRIMIT TË PUBLIKUT LOKAL
Kuvendi i Komunës së Malishevës
Instituti za Administrirani të Publičit Lokal
Opština Malisheva
Institute of Local Government Administration

Data: 21.11.2018
Titulli: _____
Lloji: _____
Niveli: _____

№ i regjistrimit të kësaj lloji	Shifra	Vlera
-VI-	010-1327	

Kuvendi i Komunës
Nr.02/2018
Datë: 21.11.2018

Në bazë të nenit 12 paragrafi 2 pika d, nenit 17 dhe 40 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008), si dhe në bazë të Statutit të Komunës së Malishevës nr.01/871 datë:12.11.2008, Kuvendi i Komunës së Malishevës në mbledhjen e -XI- të mbajtur më datë:16.11.2018 merr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet nga Kuvendi i Komunës vendimi që kërkohet nga Kryetari i Komunës z. Ragip Begaj që pas ngritjes së aktakuzës për dyshim për marrje të ryshfetit dhe dështimit në menaxhimin e Gjimnazit "Hamdi Berisha" në Malishevë të shkarkojë nga detyra e drejtorit z. Izet Hoti.
2. Gjithashtu kërkohet shkarkimi i drejtorit të Shkollës fillore dhe të mesme të ulët "Ibrahim Mazreku" në Malishevë z. Januz Mazreku, për shkak të dështimit në menaxhimin e shkollës dhe përmbushjes së detyrave dhe përgjegjësiave të drejtorit të shkollës.
3. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset: Kryetari i Komunës përmes Drejtorisë për Arsim dhe Edukim.
4. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Malishevës, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, konform nenit 81 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 17 të Rregullores nr.01/2017, për procedurën e hartimit dhe publikimit të akteve të Komunës, dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose ueb-faqen e Komunës.

Vendimi ju dërgohet:
Arkivit të Komunës
Kryetarit të Komunës
Drejtorisë për Arsim dhe edukim
MAPL-së.

Kryesuesi i Kuvendit
Rrahim Morina